



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 32
Prishtinë, më 6 tetor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 6 DHE 7 TETOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari, deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 shtator 2011,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e adresave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim Rural,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azilin,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sport,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë,

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nisma legislative,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, jashtë vendit,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës,
14. Shqyrtimi i Projekt-planit hapësinor 2010-2020 -Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re",
15. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë dhe Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020,
16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
18. Shqyrtimi i Propozimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij,
19. Njoftimi i deputetëve nga radha e komuniteteve ashkali, egjiptas dhe goran për ndarjen e mandateve për përfaqësimin e tyre në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: Ismet Beqiri, Arsim Bajrami, Visar Ymeri, Vesna Mikiq, Arben Gashi, Xhavit Haliti, Glauk Konjufca, Nazane Breca dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Fadil Demaku, parashtoi pyetje për ministrin Dardan Gashi, në lidhje me ndotjen e mjedisit në Republikën e Kosovës, e në veçanti në komunat: Kastriot, Mitrovicë, Drenas dhe Hani i Elezit, komuna ku operojnë industritë e rënda.

Ministri Gashi, iu përgjigj pyetjes së deputetit Fadil Demaku.

Deputeti Hashim Deshishku, parashtoi pyetje për ministrin Bedri Hamza, në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për kompensimin e 572 punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj.

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit Hashim Deshishku.

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me mungesën e zëdhënësit në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 shtator 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 22 shtator 2011.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e adresave

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për sistemin e adresave.

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e domosdoshme dhe rrjedh nga problemet e shkaktuara në teren, siç janë: vështirësitë në shpërndarjen e dërgesave postare, gjetjen e adresave dhe identifikimin e objekteve të ndryshme infrastrukturore, vështirësitë në biznese etj.

Në vazhdim, tha se ky projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat, kriteret, dhe rregullat në fushën e emërimit të saktë të vendbanimeve, shesheve, rrugëve, objekteve etj.

Ministri më tej u fokusua në strukturën e këtij projektligji dhe në bashkëpunimin me ministrinë dhe institucionet tjera për çka theksoi se nuk ka munguar mbështetja e ofruar për kompletimin e këtij projektligji.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për sistemin e adresave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje, si dhe deputeti, Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim, Projektligjin për sistemin e adresave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se kjo fushë deri më tani nuk ka qenë e mbuluar me ligj të veçantë, por me akte nënligjore, ndërsa miratimi i këtij projektligji do ta plotësojë infrastrukturën ligjore për këtë çështje në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe të drejtën e presidentit për ndarjen e dekoratave.

Në vazhdim, tha se ky projektligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me dhënien dhe revokimin e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës, për qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave të saj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, dhe në emër të Grupit Parlamentar ”6+”, Albert Kinolli, deputetët: Sabri Hamiti, Albulena Haxhiu, si dhe zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim Projektligjin për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Ministri **Blerand Stavileci**, tha se rëndësia e këtij projektligji konsiston në krijimin e kornizës ligjore nga kjo fushë.

Ai më tej tha se ky projektligj rregullon organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, marrëdhëniet ndërmjet palëve me interes dhe me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Republikën e Kosovës.

Ai më tej u fokusua në risitë dhe përparësitë që do të sjell ky ligj pas miratimit tij, për përparimin e bujqësisë në baza profesionale në shkallë vendi.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe ministri Blerand Stavileci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	54,
Kundër-----	7,
Abstenime-----	5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim, Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se arsyet për nxjerrjen e këtij projektligji qëndrojnë në përfshirjen në tërësi të çështjeve që kanë të bëjnë me kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit dhe të dispozitave ndëshkuese.

Në vazhdim, tha se ky projektligj rregullon në mënyrë koncize kontrollin kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, bashkëpunimin ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar dhe bashkëpunimin policor ndërkombëtar.

Ai sqaroi më tej strukturën e këtij projektligji dhe pjesëmarrësit në hartimin e tij, duke theksuar kontributin e përfaqësuesve ndërkombëtarë, si, ICITAP, UNDP, ICO, EULEX. Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Quni, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Ganimete Musliu, në emër të lëvizjes “Vetëvendosje” Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Behar Selimi, Aurora Bakalli dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim, Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azilin

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për azilin.

Ministri **Bajram Rexhepi**, fillimisht tha se nxjerrja e këtij Projektligji është me prioritet të madh e cila theksohet edhe në Raportin e progresit për Kosovën.

Në vazhdim, tha se ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e trajtimit të azilkërkuesve, refugjatëve, personave me mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese në Republikën e Kosovës.

Ai sqaroi më tej se dispozitat e këtij projektligji rregullojnë dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshme, personave që kanë nevojë si dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës, të prejardhjes ose në një vend të tretë.

Ministri Rexhepi më tej sqaroi se në përgatitjen e këtij projektligji kanë marrë pjesë njohës të mirë të çështjeve që kanë të bëjnë me ekspertimet forenzike dhe ekspertët nga ICITAP, UNDP, UNHCR, ICO, EULEX dhe OSBE.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për azilin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetja Ganimete Musliu, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetja, Aurora Bakalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	69,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim Projektligjin për azilin.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sport

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për Sport.

Ministri **Memli Krasniqi**, tha se nxjerrja e këtij projektligji është e një rëndësie të veçantë, sepse Kosovës i mungon legjislacioni gjithëpërfshirës në këtë fushë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj parasheh rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me organizimin, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive sportive, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të tyre, garat sportive, financimin, mbikëqyrjen si dhe themelimin, regjistrimin dhe menaxhimin e organizatave sportive.

Ai më tej u fokusua në plotësim- ndryshimet e parapara në këtë projektligj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për Sport.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Vataj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu,

në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanović dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Haki Demolli, Ganimete Musliu, Nazane Breca, Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi dhe Lutfi Haziri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/24 për sport.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për policinë.

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se arsyet e nxjerrjes së këtij projektligji qëndrojnë në harmonizimin e tij me ligjin në fuqi për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Në vazhdim, tha se ky projektligj rregullon autorizimet dhe detyrat e policisë së Republikës së Kosovës, strukturën organizative të saj dhe çështjet të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e policisë së Republikës së Kosovës.

Ai më tutje foli për strukturën e këtij projektligji si dhe për kontributin e dhënë nga ekspertë të mekanizmave ndërkombëtare nga kjo fushë.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për policinë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje” deputeti, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Behar Selimi, Agim Kuleta, Haki Demolli, Suzan Novoberdaliu dhe Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim Projektligjin për policinë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nisma legislative

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për nisma legislative.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, deputeti Arsim Bajrami.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për nisma legislative.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, propozoi që seanca e sotme të mbyll punimet për të vazhduar ditën e nesërme, më 7 tetor 2011 në ora 10:00.

Kryesuesi e përfundoi mbledhjen e sotme në orën 16:45 minuta.

E premte, 7 tetor 2011, Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, nënkryetar i Kuvendit.

Kuvendi i vazhdoi punimet me pikën e 12-të të rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Ministri **Agim Çeku**, në fillim të fjalës së tij shpjegoi bazën ligjore të këtij Propozim-vendimi, e cila qëndron në nenin 126.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 2.1 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në vazhdim, ai foli për rëndësinë dhe llojet e operacioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, ndërsa për përcaktimin e përgjegjësiave dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, theksoi se kërkohet miratimi nga Kuvendi i Kosovës.

Më tej, ai foli edhe për çështjet procedurale të këtij propozim-vendimi.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Propozim-vendimit për përcaktimin e përgjegjësiave dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, nga ana e Kuvendit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim, dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Shaip Muja, Halit Krasniqi, Glauk Konjufca, kryetari Jakup Krasniqi dhe ministri Agim Çeku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, **kryetari** hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe të procedurave për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës

Deputetja **Valbona Dibra**, në emër të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se komision ka monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim. Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij Raporti bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	54,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

14. Shqyrtimi i Projekt-planit hapësinor 2010-2020 -Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re"

Në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti **Liburn Aliu** tha se ky komision ka shqyrtuar Projekt-planin hapësinor 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projekt-planit hapësinor 2010-2020 -Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re".

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projekt-plan, dhanë: ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Dardan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje, si dhe deputetët: Justina Shiroka-Pula, Ardian Gjini dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, **kryetari** hodhi në votim Projekt-planin hapësinor 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re".

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Plani hapësinor 2010-2020 - Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re".

15. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë dhe të Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020

Në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti **Liburn Aliu** tha se ky komision ka shqyrtuar Propozim-strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2011-2020 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-strategjisë dhe të Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-strategji, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së,

Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Shaip Muja, Liburn Aliu, Bekim Haxhiu, Armend Zemaj, Flora Brovina, Glauk Konjufca, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Ali Sadriu, si dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, **kryesuesi** hodhi në votim Propozim-strategjinë dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2011-2020.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia dhe Plan i veprimit për biodiversitetin 2011-2020, sipas vërejtjeve nga Qeveria (Departamenti për Buxhet nga Ministria për Financa).

16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010

Kryesuesi ftoi Avokatin e Popullit që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin e punës së këtij institucioni, për vitin 2010.

Avokati i Popullit, **Sami Kurteshi**, tha se në Republikën e Kosovës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut ballafaqohemi me dy kundërshti: kërkesat e mëdha dhe, nga ana tjetër, mundësitë e vogla.

Në vazhdim, Avokati i Popullit tha se rastet e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut nuk kanë rezultuar me ndonjë zvogëlim të numrit gjatë kësaj periudhe raportuese, ndërsa zgjidhja e këtyre rasteve vazhdon të jetë e koklavitur.

Avokati i Popullit më pas u fokusua në numrin e rasteve të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, nga ana e qytetarëve të Kosovës dhe në përqindjen e rasteve të zgjidhura.

Deputetja, **Suzana Novoberdaliu**, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione tha se komisioni që ajo drejton ka shqyrtuar Raportin vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ndërsa, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja **Safete Hadergjonaj** tha se ky komision ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Justina Shiroka-Pula, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kimete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar, “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Ramiz Lladrovci dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja **Safete Hadergjonaj** tha se ky Komision ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në vazhdim, ajo u fokusua në aspekte të veçanta të këtij raporti, ndërsa theksoi se komisioni që ajo drejton ka qenë unanim në përkrahjen e Raportit vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Ndërsa, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Raportin me rekomandime para deputetëve e prezantoi, deputeti, **Ali Sadriu**.

Deputeti Sadriu një pjesë të mirë të fjalës së tij ia kushtoi politikave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në raport me normat e interesit me të cilat operojnë Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës, për të cilat tha se këto norma të interesit shkojnë në dëm të qytetarëve të Kosovës, por edhe të vetë shtetit të Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”,

Albert Kinolli, deputeti Shaip Muja, si dhe kryetari Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor i punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

18. Shqyrtimi i Propozimit i Avokatit të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij

Në emër të Komisionit për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja **Suzana Novoberdaliu** tha se komision ka shqyrtuar Propozimin e Avokatit të Popullit lidhur me emërimin e zëvendësve të avokatit të popullit, dhe Kuvendit i ka rekomanduar që të mos miratohet lista e kandidatëve të propozuar për zëvendës të avokatit të popullit.

Ajo më tej u fokusua në rekomandimin e komisionit që ajo drejton lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Justina Shiroka-Pula, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Imri Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Ramiz Lladrovci, Suzana Novoberdaliu, Visar Ymeri dhe Lutfi Haziri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, **kryetari** hodhi në votim Propozimin e Avokatit të Popullit lidhur me emërimin e zëvendësve të tij.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40,
Kundër----- 25,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Kuvendi zgjodhi zëvendësit e Avokatit të Popullit, si në vijim:

1. Basri Berisha
2. Isa Hasani
3. Boguljub Statletoviç
4. Shqipe Ibraj – Mala
5. Ibrahim Arslan.

II. Mandati i të emëruarve nga pika nr. I. e këtij vendimi është tre (3) vjet.

19. Njoftimi i deputetëve nga radha e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe goran për ndarjen e mandateve për përfaqësimin e tyre në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Kryetari njoftoi Kuvendin se komunitetet ashkali, egjiptian dhe goran, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, në bazë të marrëveshjes kanë propozuar ndarjen e mandateve në Komisionin për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim, për një periudhë 12 mujore.

Kryetari hodhi në votim propozimin e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe goran

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

I. Ndarja e mandateve në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, bëhet për një periudhë 12 mujore, si në vijim:

1. Etem Arifi, mars 2011 – shkurt 2012,
2. Xhevdet Neziraj, mars 2012 – shkurt 2013,
3. Mursel Halili, mars 2013 – shkurt 2014.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 16:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.